



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

Kosovo Investment and Enterprise Support Agency

Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu

Thirrje publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin “imm Spring Edition 2023” në Koln/Gjermani

Me qëllim të promovimit të produkteve të Kosovës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) promovon bizneset e sektorit i drurit në panairin ndërkombëtar “imm Spring Edition 2023” në Koln/Gjermani me date 04.06.2023-07.06.2023.

Paraqitja shtetërore organizohet nga MINT përkatësisht KIESA, e cila mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e shtandit, regjistrimin e pesë (5) subjekteve pjesëmarrëse, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor etj, ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimit e materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Ju lutem vini re se vetëm shprehjet e interesimit të dërguara deri me datë 03.03.2023 dhe vetëm aplikacionet e plotësuara tërësisht mund të konsiderohen për vlerësim.

1. Për të aplikuar duhet dorëzuar:

- 1.1. Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues; dhe
- 1.2. Dokumentet e kërkuara.

2. Dokumentet e domosdoshme për aplikim:

- 2.1. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
- 2.2. Dëshminë e xhirlogarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
- 2.3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
- 2.4. Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (jo më i vjetër se 30 ditë).
- 2.5. Deklaratën nën betim;
- 2.6. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2021 nga Administrata Tatimore e Kosovës (Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera nga ATK); dhe
- 2.7. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e veçanta të listuara më poshtë.

1. Pesë (5) subjektet pjesëmarrëse do të përzgjidhen sipas kriterëve të veçanta në vijim dhe rangimit të pikëve:
 - 1.1. Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë: tre (3) pikë për një (1) produkt, gjashtë (6) pikë për dy (2) produkte, nëntë (9) pikë për tri (3) produkte, dymbëdhjetë (12) pikë për katër (4) produkte dhe pesëmbëdhjetë (15) pikë për pesë (5) e më shumë produkte;
 - 1.2. Njohuria e gjuhëve të huaja dhe aftësi prezantuese të përfaqësuesve të subjektit aplikues, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë kumulative: gjuha Angleze gjashtë (6) pikë, gjuha Gjermanisht gjashtë (6) pikë dhe gjuhët tjera tre (3) pikë;
 - 1.3. Materiale promovuese të subjektit aplikues në gjuhët e huaja, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë kumulative: në gjuhën Angleze gjashtë (6) pikë, në gjuhën Gjermanisht gjashtë (6) pikë dhe tre (3) pikë në gjuhë tjera evropiane;
 - 1.4. Shtetet ku janë eksportuar produktet e subjektit aplikues gjatë viteve 2021 dhe 2022, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë kumulative: shtetet anëtare të BE-së gjashtë (6) pikë, shtetet e Ballkanit Perëndimor që nuk janë anëtare të BE-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut) gjashtë (6) pikë dhe tregjet e tjera tre (3) pikë;
 - 1.5. Certifikimi ndërkombëtar i subjektit aplikues, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë kumulative: FSC CoC gjashtë (6) pikë, ISO 14001 gjashtë (6) pikë dhe certifikim tjetër relevant tre (3) pikë;
 - 1.6. Paraqitja e subjektit aplikues në panair tri (3) vitet e fundit (2020, 2021, 2022), maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë: një (1) panair tre (3) pikë, dy (2) panair gjashtë (6) pikë, tri (3) panair nëntë (9) pikë, katër (4) panair dymbëdhjetë (12) pikë dhe pesë (5) e më shumë panair pesëmbëdhjetë (15) pikë; dhe
 - 1.7. Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2021, maksimumi dhjetë (10) pikë: nga zero deri në 500.000 euro katër (4) pikë; nga 500.001 deri në 1.000.000 euro tetë (8) pikë dhe mbi 1.000.000 euro dhjetë (10) pikë;

Më 28.02.2023 në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, ekspertët e KIESA-s do të organizoj sesion informues dhe do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe për mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë në mënyre elektronike atë më së largu deri më 03.03.2023 në e-mail adresën Export.Kiesa@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe aplikacioni për shprehje të interesit mund të merren në MINT/ KIESA apo të shkarkohen nga faqet e internetit mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën Export.Kiesa@rks-gov.net